



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR			
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA			
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING			
Mjësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	SA-02	Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	8276-2/25
Nr. i faqeve Broj. stranica No. pages	-03-	Data. Datum: Date:	24.10.2026
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	14.04.2026
REFERENC-Ë:	25/8276/708/DMM
PËR/ZA/TO:	Kompania "Isufi" Sh.p.k., Rahovec
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot.: 25/8276/708/DMM, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për **Përfundim të procedurës administrative** të kërkesës së Kompanisë "Isufi" Sh.p.k., Rahovec.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://ëëë.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

Përfundim të procedurës administrative të kërkesës së Kompanisë "Isufi" Sh.p.k., Rahovec, e cila ka aplikuar për bazë të prodhimit të betonit në Z.K. Dobidol, Komuna Rahovec, me nr.prot. 25/8276/708/DMM, të datës 10.11.2025.

A r s y e t i m

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Raportit të VNM-së dhe dokumentacionit përcjellës të Kompanisë "Isufi" Sh.p.k., Rahovec, është konstatuar se:

- Parcela për të cilën është aplikuar bazuar në HZ është në zonën bujqësore, ku nuk lejohet aktiviteti për të cilin është aplikuar;
- Mungon Licenca e hartuesit të Raportit të VNM-së.

Faqe 2 nga 3



Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, Neni 17, Paragrafi 2, 3 dhe 4, Kompanisë "Isufi" Sh.p.k., Rahovec, me datën 08.12.2025 i është dërguar njoftimi për plotësim të dokumentacionit.

Dokumentet e kërkuara nuk janë sjellë në bazë të njoftimit për plotësim dokumentacioni.

Bazuar në të lartcekuat, Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së merr vendim për **Përfundimin e Procedurës Administrative** të kërkesës për pajisje me Pëlqim Mjedisor për Kompaninë "Isufi" Sh.p.k., Rahovec.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Vërejtje: Afati për shqyrtimin e lëndës është tejkaluar për shkak të zëvendësimit të Sekretarit të MMPH-së

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Nr.: 25/8276/1- ZSP/ /26, datë: 14.04.2026
Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Komunës së Rahovecit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
6. Divizioni për Komunikim me Publikun
7. Arkivit të MMPHI

